



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së shtatë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,  
mbajtur më 02.12.2021, e cila filloi në orën 13:30.**

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e komitetit: Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Jeton Canhasi, Gyltene Retkoceri, Ermira Shabani.

**Mungoi: Armend Ademi.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut, Antigona Axhani - Baftijaj nga Komuna e Kaçanikut, Arlinda Krasniqi nga Komuna e Drenasit dhe Arbër Xharra nga Komuna e Gjakovës.

**RENDI I DITËS**

**1. Takim kushtuar 3 dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara**

Takimin e hapi anëtarja e komitetit Ermira Shabani, si organizatore e një takimi në distancë të komiteteve homologe në Kosovë, për ndër të 3 dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ku u prezantua si anëtare e KKPAK-së në Komunën e Prishtinës, me profesion psikologe, e cila vije nga Komuniteti i Sindromit Down.

Ky Komitet në Komunën e Prishtinës ekziston që nga viti 2016. Kemi menduar se edhe komunat tjera në Kosovë, apo shumica sish do të duhej t'i kenë të themeluara komitetet për PAK, por kam kuptuar se përveç Prishtinës, Komitet Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara kanë vetëm edhe katër komuna të Kosovës: Drenasi, Gjakova, Kaçaniku dhe Mitrovica.

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara i Komunës së Prishtinës, takimet me entitetet homologe i ka pjesë të programit të vet të punës. Një takim të përbashkët e kemi pasur me Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara të Komunës së Kaçanikut, i cili është mbajtur më 08.10.2019, por për shkak të rrethanave epidemiologjike

dhe pasi që na mundëson teknologjia, kemi menduar të mbahet takimi në distancë.

Qëllimi i këtij formati të komunikimit është këmbimi i përvojave rreth funksionimit të Komiteteve Konsultative për PAK në komunat përkatëse, gjendjes së aftësisë së kufizuar, si dhe praktikave të mira dhe sfidave në këtë drejtim.

Nga takimi presim ide dhe rekomandime, me qëllim që, përmes monitorimit të rregullativave për PAK dhe veçmas të monitorimit të zbatimit të tyre, të kontribuojmë në përmirësimin e pozitës shoqërore të këtyre personave në nivelin lokal.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese i përshtëndeti dhe i falënderojë për pjesëmarrje, përfaqësuesit e KKPAK të komunave tjera në këtë organizim të KKPAK të Komunës së Prishtinës, i cili organizim i dedikohet Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.**

Ne jemi të privilegjuar sepse para pesë vitesh, pra të parët në Republikën e Kosovës, kemi qenë të thirrur ta themelojmë Komitetin Konsultativ në Komunën e Prishtinës, si mekanizëm i ri institucional lokal për persona me aftësi të kufizuara.

Tashmë jemi të konsoliduar dhe për dy mandate kemi dhënë maksimumin që, mbi eksperiencën tonë, kualifikimin dhe eupatinë, ta japim kontributin për persona me aftësi të kufizuara, ku për këtë u jemi mirënlohës Institucioneve komunale për besimin e dhënë,

Shoqatave të komunitetit me aftësi të kufizuara për bashkëpunim; Organizatave dhe institucioneve tjera për mbështetje; si dhe individëve, persona me aftësi të kufizuara, për rritjen e interesimit për Komitetin dhe punën e tij. Komiteti Konsultativ për PAK i Komunës së Prishtinës, në bazë të vendimit të Komisionit Intervistues të Komunës, është konstituuar më 26 korrik 2016, në përbërje prej pesë anëtarëve, njohës të paaftësive: verbërisë, shurdhërisë, paralogjisë / tetraplegjisë, Sindrom Dawn, dhe Autizmit. Ndërkëq, në mandatin e dytë, me vendim të Komunës, të datës 29 korrik 2019, themelohet Komiteti, në përbërje të shtatë anëtarësh. Për t'i definuar dhe qartësuar më tej detyrat dhe përgjegjësitet e veta brenda kompetencave të dala nga Vendimi i Komunës së Prishtinës, Komiteti ka miratuar Udhërrëfyesin mbi punën dhe veprimtarinë e këtij komiteti.

Objektivat bazë të këtij komiteti janë: nxitja, mbrojtja dhe sigurimi i mundësisë që të gjithë PAK në territorin e Komunës së Prishtinës t'i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

E tërë puna dhe veprimitaria e Komitetit për periudhën mandatore, në aspektin dinamik, varet nga koha e shtruarjes së çështjeve tematike nga kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës, komitetet e përhershme, si dhe vetë Komiteti, e të cilat tema janë: dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarrja nga kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës apo komitetet e përhershme, në fushën përkatëse, paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve persona me aftësi të kufizuara tek kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, si dhe propozime për zgjidhjen e problemeve të identikuara.

Komiteti i merr në konsideratë parashtresat, apo propozimet eventuale të qytetarëve PAK apo të organizatave joqeveritare që i përfaqësojnë ata në nivelin lokal të qeverisjes në Prishtinë, lidhur me çështjet e targetuara nga përbajtja dhe fryma e Udhërrëfyesit.

Sipas rregullativës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Komiteti mban katër mbledhje të rregullta në vit dhe dy tjera eventuale, kurse aktivitetet tjera dhe takimet i zhvillon në terren dhe sipas rastit.

Përveç mbledhjeve, Komiteti ka pasur edhe takime me përgjegjësit e dikastereve të drejtoreve komunale, si dhe ka ndjekur një trajnim në kuadër të projektit "Më shumë përfaqësim për PAK".

Por, me qëllim të efektshmërisë, Komiteti, në raste të caktuara, ka mbajtur edhe takime konsultative joformale, si dhe ka zhvilluar kontakte me institucione, me asociacione dhe me individë që ka konsideruar se mund të jenë aleatë të orientimeve të tij për të drejtat dhe mundësitetë e personave me aftësi të kufizuara.

Komuna e Prishtinës është sugjeruar edhe nga "Handikos" Prishtina, pesë organizata tjera të aftësisë së kufizuar, KKPAK të Komunës së Prishtinës, si dhe grupit të veçantë komunal, të themeluar me vendim të kryetarit të Komunës, ka hartuar Planin e veprimit për PAK, 2018-2021, i cili plan është prezantuar dhe miratuar në Kuvendin e Komunës së Prishtinës në tetor të vitit 2018. Ky dokument është publik dhe me një rëndësi të veçantë për komunitetin, i cili përshkruan konceptet se si komuna do t'i qaset diversitetit dhe gjithëpërfshirjes, si dhe specifikon synimet dhe planet e saj për të eliminuar diskriminimin e kësaj kategorie të qytetarëve.

Komiteti ka monitoruar zbatimin e këtij plani në periudhën trevjeçare, ku nga analiza rrjedh se prej 36 pikave të renditura për monitorim:

- Tërësisht janë realizuar nëntë (9) sosh, apo (25%);
- Pjesërisht janë realizuar trembëdhjetë (13) sosh, apo (36.11%); si dhe
- Nuk janë realizuar katërmëdhjetë (14) sosh, apo (38.88%).

Megjithatë, ajo që mbetet ende sfida kryesore për t'u jetësuar është pika e parë e planit, përkatesisht arritja e kuotës së punësimit, e që është 1 person me aftësi të kufizuar në 50 punëtorë të punësuar, d.m.th. 2% e të gjithë të punësuarve.

Në qershor të këtij viti, Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Komitetin, ka hartuar dhe miratuar Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara, 2021-2024, zbatimi i të cilit presim të jetë në përqindje më të madh.

Prej të gjitha pikave të raportimeve që vijnë në Komitet nga Plani i Veprimit, e ajo që më së shumti e preokupon personin me aftësi të kufizuar është punësimi, i cili ende ngec.

Mbi bazën e të dhënave nga monitorimi i Planit të veprimit në Komunën e Prishtinës, vetëm në domenin e punësimit, rezulton se prej 4.398 të punësuarve, 15 të punësuar janë PAK, apo, shprehur në përqindje, vetëm 0.36%.

Që nga themelimi i vet, Komiteti është përballur me sfida, por ka pasur edhe rezultate në punën e vet. Personalisht, kam bindjen se pritshmëria për këtë Komitet ka qenë më e madhe si nga brenda ashtu edhe nga jashtë Komitetit. Disa herë kemi debatuar nëpër takime të Komitetit pse nuk i përfillin institucionet komunale opinionet tona, në përbërjen tonë ka mjek, psikologë, pedagogë, inxhinierë, juristë etj., ndaj dhe opinionet tona janë racionale. Pse nuk na pranojnë shpesh në takime e as që u përgjigjen shkresave tona, ku ka situata më sensitive, dhe një takim mund ta zgjidhë problemin, pse shoqatat komunitare shpesh na anashkalojnë, kur

pothuajse secili kemi ardhur këtu me rekomandimet e tyre, e njëjta gjë ndodh edhe nga individë komunitarë.

Megjithatë, si Komitet, përveç punës tonë të rregullt, kemi gatishmërinë dhe vullnetin për tu marrë me secilin problem që paraqitet për aftësinë e kufizuar apo nga aftësia e kufizuar në Komunën tonë.

**Premtime Preniqi** theksoi se ky Komitet me të vërtetë e ka një vlerë shumë të madhe. Siç e ceku edhe kryesuesja e KKPAK, ky komitet ka pasur shumë probleme, të cilat nuk ka gjetur mirëkuptim ndoshta në institucionet brenda Komunës, mirëpo mbështetje ka pasur nga unë dhe nga nënkyetari, z. Muheidin Nushi. Komunën e Prishtinës e përbëjnë 10% e popullatës PAK-ra. Është një diskriminim i madh kur e marrim parasysh aspektin e infrastrukturës dhe punësimit, si koordinatorë për të drejtat e njeriut. Ne kemi punuar shumë në aspektin e infrastrukturës ligjore, e kemi komitetin edhe prej nivelit qendror, ligjet, rregulloret, udhëzimet e ndryshme, mirëpo kur vjen puna te elementet kyçe të cilat PAK t'i ketë aty, si shoqëri stagnojmë, sidomos te punësimi, as minimalisht nuk realizohet punësimi për PAK, ku nuk e kalon as 1% e të punësuarve, përderisa Ligji e parashev 10 me 1. Kjo nuk ndodh vetëm në Komunën e Prishtinës, por në përgjithësi në territor të Kosovës, çka është shumë e dhimbshme se PAK kanë kualifikime të ndryshme, të cilat çdo pozitë kishin mundur me përm bushur, ku njérën anë ishin larguar nga pjesa sociale, dhe në anën tjetër ishin integruar në shoqëri.

Ne si Komunë jemi munduar disa çështje me i rregulluar gjatë këtyre viteve, siç është me bashkëpunimin e OJQ-ve, ku si Komunë ka ndarë objekte për të cilat nuk paguajnë qira, mandej ju kanë bërë disa pagesa tjera këtyre organizatave që jepin shërbime për PAK, mirëpo kjo nuk i plotëson as kushtet minimale.

Komiteti i PAK ka bërë një punë të madhe deri tani, do t'i shtyjë edhe më tutje këto çështje të cilat i preokupojnë PAK dhe gjithmonë do të jemi krah i tyre për atë çka unë dhe çka ma lejon mandati im do t'i përkrahi.

**Arlinda Krasniqi, anëtare e KKPAK i Komunës së Drenasit**, i përshëndeti të pranishmit, tha me vet faktin që është themeluar KKPAK, ka dhënë prioritetet e veta mbi këto kategori të qytetarëve, ky komitet është themeluar në shtator të vitit 2019, i përbërë prej 5 anëtarëve dhe vazhdon me punuar në harmoni me Udhëzimin administrativ 01/2016, për t'i arritur objektivat. KKPAK në fillim të vitit e ka hartuar edhe Planin e punës dhe kalendarin e takimeve për vitin 2020 – 2021, në bazë të të cilat ka arritur me i realizuar aktivitetet, ky komitet ka të drejt t'i mbajë 6 takime të rregullta dhe 3 takime konsultative, ose edhe më tepër, varësisht prej aktivitetave që i përmban plani vjetor. Ne si komitet i kemi radhitur prioritete gjatë vitit 2020-2021, ku kemi qenë në bashkëpunim edhe me OJQ për PAK, e në veçanti me "Hendikos" për t'i dëgjuar kërkuesat dhe propozimet e tyre. Prioritet tjetër ka qenë se Komuna e Drenasit çdo vite ka ndarë një fond-buxhet për organizatat që ofrojnë brenda komunës së Drenasit, ne si komitet kemi lobuar që kësaj organizate me iu ndarë më shumë fonde-mjete përkrahëse për shkak të numrit të madhe të aktivitetave që bëjnë dhe pjesëmarrësve që bëjnë shërbime. Prioritet tjetër ka qenë edhe shkëmbimi i përvojave me homolog ish-anëtarë të komitetit nga komunitat tjera për përvojat pozitive në kuadrin ligjor, bazueshmërinë e tij në organizimin, rolin, aktivitetet etj.

Prioritet tjetër ka qenë kërkesat, kritikat, propozimet e qytetarëve që kanë të bëjnë me investimet, ndërtimet dhe përmirësimin e infrastrukturës shkolllore, rrugëve, trotuareve etj., ofrimin e shërbimeve shëndetësore PAK, prioritet tjetër ka qenë edhe hulumtimi në terren e aspekteve prioritare që kanë të bëjnë me PAK. Prioritet tjetër ka qenë hartimi i udhëzimeve dhe dhënia e propozimeve në rregulloret e hartuara që ndërlidhen me PAK -ra, identifikimi i numrit të llojeve të PAK që regjistrohen në Zyrën e regjistrimit si të papunë, punëkryrës dhe të punësuar, shifrat për vitet e fundit, identifikimi i numrit të fëmijëve nën moshën 18 vjeçare, personave mbi moshën 18 vjeçare që janë aktivë në marrjen e pensioneve si PAK, të bëra analiza mbi numrin e përgjithshëm të banorëve në Drenas dhe PAK.

Si komitet, më së shumti u kemi kushtuar rëndësi të gjitha moshave të PAK, prioritet i kemi dhënë fëmijëve, nxënësve për me shikuar se sa po bën Drejtoria e Arsimit për këtë kategori. Ne më së shumti që kemi kërkuar mbështetje në Drejtorenë e Arsimit, ka qenë numri ose identifikimi i saktë i nxënësve që janë me nevoja të veçanta në komunën e Drenasit, identifikimi i nxënësve të cilët kanë plan individual të arsimit, të nxënësve që kanë mbetur pa plan individual të arsimit. Prioritet tjetër ka qenë mbështetja e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkolla me asistente, ku për momentin janë vetëm 4 asistentë dhe 2 mësues mbështetës, që është një numër tepër i ulët. Në vitin e kaluar kemi kërkuar rritjen e numrit të mësuesve mbështetës për 8 shkolla dhe bashkëpunimin më të madh me DKA, ku kemi marrë premtim nga DKA që për vitin 2021 dhe ndarjes buxhetore që ka bërë Ministria e Arsimit, kanë me u bërë edhe 3-4 asistentë për komunën e Drenasit dhe ka me vazhduar punësimi i psikologëve dhe mësuesve mbështetës për këta nxënës. Në bazë të aktivitetit, Komiteti ynë ka propozua identifikimin për rregullimin edhe të pjerrinave dhe qasjes më të letë për këta persona.

**Antigona Axhani - Baftijaj - anëtare e KKPAK të Komunës së Kaçanikut,** theksoi se KKPAK i Kaçanikut është themeluar më 13 shtator 2019, në përbërje të 7 anëtarëve, kryesues është zgjedh Artan Mezraja. Në Kaçanik janë rreth 400 PAK.

Komiteti ka mbajtur edhe takime konsultative jo formale, si dhe ka zhvilluar takime me institucionë dhe individ që kanë konsideruar se mundë të jenë aleatë të orientimeve të tyre për të drejtat dhe mundësitë e PAK, po ashtu Komiteti ka pasur takime edhe me Komunën e Prishtinës dhe të Hanit të Elezit.

Gjatë këtij mandati kemi bërë edhe monitorimin e Planit të veprimit të PAK për periudhën 2019 -2021, e miratuar nga Kuvendi i Komunës. Po ashtu, kemi arritur edhe dy marrëveshje në formë memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet një biznesit privat dhe organizatave që përfaqësojnë PAK. Në Komunën e Kaçanikut janë 3 asistentë nëpër shkolla. Për 3 dhjetorë të këtij viti kemi organizuar ligjérata në disa shkolla për vetëdisimin e nxënësve për PAK në komunën tonë dhe takim me "Hendikos", takim me kryetarin e Komunës, në bashkëpunim për PAK. Kemi qenë pjesëmarrës në takim me "Hendikos" për strategjinë e "Hendikos" dhe aty kemi kërkuar që gjimnazi "Skënderbeu" nuk ka pjerrina dhe PAK në atë hapësirë nuk kanë qasje.

**Ermira Shabani** tha se në agjendë kemi edhe përfaqësues të komiteteve të komunave, si të Gjakovës, i cili ishte i kyçur, por tanë ka dalë, si dhe të Komunës së Mitrovicës, Kamenicës, të cilët nuk janë kyçur fare.

**Ramadan Salihu** i përshëndeti të pranishmit dhe kolegët nga komitetet homologe që janë bashkangjitur.

Unë do të flas për komitetin çka ndjej, jo çka di. E para, që nga themelimi e kemi pasur atë betejën me veti, ta kuptojmë rolin tonë si anëtarë të komitetit, detyrat tona dhe pritjet tona, dhe kemi parë ne se nuk guxojmë të jemi rebel ndaj institucioneve që na kanë zgjedhur dhe të mos jemi shpresëdhënës të njerëzve, sepse nuk kemi shumë kompetenca vetëm opinion racionall për një çështje të caktuare dhe mundë ta monitorojmë zbatimin e normave që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës, posaçërisht ato norma të nivelit lokal të qeverisjes.

Po ashtu, ceku se u përmend nga kryesuesja se nuk konsultohemi sa duhet, se anashkalohemi shpeshherë edhe pritjet tona janë më të mëdha sesa rezultatet, e kjo është evidente sepse PAK edhe Prishtinë, edhe si çdokund i kanë nevojat e veta, por i kanë edhe të drejtat. Për nevojat angazhohen vet dhe OJQ e tyre dhe fare ose thuaje në mënyrë simbolike na konsultojnë neve për nevoja sociale, nevoja infrastrukturore, d.m.th. gjithë ato tema që ata i ndajnë me neve janë temat e të drejtave, pra jo të nevojave sepse nënkuption të drejtat që i parashohin Ligjet e ajo në këtë rast është punësimi, pika kryesore që e preokupon PAK, se punësimi është faktori kryesor dhe elementë i dukshëm i integrimi të PAK në shoqëri, sepse nëse shoqëria jonë e pranon në vete për të punësuar një PAK, ajo do të thotë se e ka pranuar atë person me të gjitha specifikat që i ka dhe ky quhet integrim.

Po ashtu, shprehu shqetësimin për tri raste që nuk janë përfillur PAK, si për punësimin e një kandidatit me aftësi të kufizuar që ka konkurruar në mënyrë të rregullt e nuk është pranuar.

Rasti tjeter është një kërkesë që e kemi pasur nga një nënë, që nuk i është pranuar fëmija me nevoja të veçanta në çerdhe në bazë me komunitet, aty afér në lagje.

Rasti tjeter është një PAK që ka aplikuar në Qendrën Klinike Universitare, është punësuar aty dhe në fund vihet në pikëpyetje pranimi i saj.

Ne si komitet kemi bërë kërkesë zyrtare për takim, për t'i sqaruar situatat e tillë edhe po të jetë ndoshta me një arsy që caktuar për PAK, duhet të ketë tretman të posaçëm, mirëpo edhe pas dy reagimeve nuk patëm përgjigje fare.

Shtrohet pyetja se kush është komiteti atëherë, kush janë këto institucione, kujt duhet t'i përgjigjen ata në një vend të konsoliduar demokratik edhe individi 18 vjeçar që paraqet kërkesë duhet organi t'i përgjigjet qoftë me negativitet, qoftë me pozitivitet, qoftë jemi në pritje, por që të mos i përgjigjet një institucion, një mekanizmi legjitim, siç jemi ne atëherë ne shpeshherë e ndiejmë veten të pafuqishëm në disa raste.

Në këto ditë, siç është dita e 3 dhjetorit - Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, ne duhet të jemi të zëshëm dhe të pohojmë këtë mospajtim tonin të mos përgjegjësisë së kompetentëve.

Unë në konkluzionet e këtij takimi do të propozoja që edhe kjo konkluzë të jetë pjesë e pikave tjera konkludente të takimit, t'i drejtohami Ministrisë së Shëndetësisë se përsë pikërisht ndaj PAK keni vepruar në këtë mënyrë.

Unë besoj se nga këto dy komitete na morëm diçka, kuptuam që atje megjithatë komiteti dëgjohet më shumë sesa te ne, besoj se edhe ata prej nesh diçka kanë marrë.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese**, e falënderoi Komunën e Drenasit që është bashkëngjitur dhe na e dha një model shumë të mirë se si po funksionon atje komiteti, duke

pasur parasysh që është themeluar tash vonë, por që ka bërë ndryshime, kjo është një fat ndoshta edhe për shkak të Komunës së vogël e cila edhe është, se munden me i evidentuar të gjitha ato vështirësi që hasin.

Po ashtu, përgëzoi që kanë arritur edhe në arsim t'i identifikojnë se cilët fëmijë janë me planin individual dhe cilët jo, ndërsa ne si Komitet i Komunës së Prishtinës ndoshta pse jemi me banorë më shumë, kemi sfida për t'i realizuar, ato të cilat po i realizojnë komunat e vogla. Po ashtu, i përgëzoj edhe për mbledhjet e mbajtura të rregullta dhe fondin e aktiviteteve të cilat i kanë.

Njëherësh falënderoi edhe Komunën e Kaçanikut, për të cilën më vjen mirë që kanë filluar me këta hapa.

E falënderojë anëtaren e Komitetit për punën që po e bën si Komitet.

Uroj që në mandatin tjetër të kyçen PAK brenda Komitetit, sepse nga përvoja është shumë më mirë, sepse dinë të tregojnë dhe lobojnë për kërkasat e veta anëtarët e PAK.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:30.*

Procesmbajtësja:  
Shyhrrete Islami

Kryesuesja e Komitetit  
Fatime Demolli - Mustafa

